



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 25 janar 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Time Kadriaj, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Liburn Aliu, Gëzim Kelmendi dhe Flora Brovina

Munguan: Fikrim Damka, Sasha Gjokiq

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi: Time Kadriaj, zv. kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 11.01.2012
3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale te financuara nga shteti, para miratimit në parim
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 2003/15, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, para miratimit në parim
5. Shqyrtimi i Raportit të monitorimit të Ligjit për Inspektoratin e punës
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare
7. Të ndryshme

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbajtur më 11.01. 2012

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale pa vërejtje e miratoi procesverbalin e datës 11 janar 2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për skemat pensionale te financuara nga shteti, para miratimit në parim

Time Kadriaj- Deklaroi se e përkrah miratimin e këtij projektligji në parim. Hapi diskutimin për diskutimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Nazane Breca- Deklaroi se përmes këtij projektligji arrihet për herë të parë të njihet e drejta për pension invalidor dhe familjar dhe për pensionin bazik të moshës, për ata të cilët kanë qenë të larguar dhunshëm nga vendet e tyre të punës dhe ata që janë larguar si tepriçë teknologjike nga organet e dhunshme të instaluar në institucionet e Kosovës. Sipas raportit të Komisionit të buxhetit, këto forma të pensioneve, për shkak të implikimeve buxhetore, nuk mund të realizohen deri më 2016. Nuk e di sa është e arsyeshme që të futen këto kategori tash në këtë projektligj, ndonëse këto nuk mund të implementohen për shkak të ngarkesës buxhetore.

Liburn Aliu- Tha se kontributet pensionale do të duhej të rriteshin dhe të bëheshin 8% për punëdhënësin dhe 8% për punëtorin. Kjo rritje do të duhej të shkonte për pensionet e shtyllës së parë, në mënyrë që të kemi pensione më dinjitoze për këtë kategori. Duhet të sqarohet më mirë logjika se si ka ndodhur rritja e numrit të pensionistëve. Trajtimi i pensioneve të shtyllës së parë dhe shtyllës së dytë ndaras nuk është në rregull. Sistemi pensional duhet të jetë i integruar. Për arsyet e lartcekura abstenoj nga miratimi në parim i këtij Projektligji.

Salihe Mustafa- Duke e vënë në pah rëndësinë e projektligjit, tha se e përkrah miratimin e tij në parim.

Gëzim Kelmendi- Tha se e mbështes në parim këtë projektligj. Është një kategori e qytetarëve që kanë dalë në pension si invalid dhe në këtë projektligj nuk janë paraparë fare.

Bahri Thaqi- Deklaroi se duhet të kemi konsultime të gjera lidhur me këtë projektligj dhe ta bëjmë një ligj të mirë për këtë kategori.

Flora Brovina- Tha se e përkrah miratimin e tij në parim. Ne do ta plotësojmë gjatë shqyrtimit të tij në Komision. Ne e dimë se çka ka ndodhur me fondin e mëparshëm dhe pikërisht për këtë mendoj se duhet të kemi një fond solidar.

Pas diskutimeve, Komisioni miratojë në parim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 2003/15, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, para miratimit në parim

Time Kadriaj- Tha se projektligji ka ardhur në Kuvend. Ne do ta diskutojmë në parim këtë projektligj.

Komisioni njëzëri miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 2003/15, për skemën e ndihmës sociale në Kosovë,

5. Shqyrtimi i Raportit të monitorimit të Ligjit për Inspektoratin e punës

Nazane Breca- Tha se kemi punuar sipas Planit të punës për monitorimin e këtij ligji. Si pjesë të raportit kemi hartuar disa rekomandime, si vijon:

- Qeveria e Kosovës , Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organet tjera përgjegjëse, duhet ti rrisin përpjekjet për zbatimin e Ligjit.
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Kuvendet Komunale duhet të rrisin bashkëpunimin dhe ti koordinojnë veprimet në mënyrë që të zbatohet sa më shumë Ligji për Inspektoratin e Punës.
- Ministria duhet të nxjerr dhe të harmonizoj udhëzimet administrative me Ligjin e Punës dhe Ligjin për Rrezikshmërinë në punë , në mënyrë që Ligji për Inspektoratin e Punës të zbatohet në masë sa më shumë .
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet të rris numrin e inspektorëve të punës dhe të mbuloj të gjitha komunat me inspektor të punës.
- Nga takimet, shihet nevoja e plotësimit ose e hartimit të një ligji të ri për inspektoratin e punës.

Komisioni njëzëri miratoi Raportin e monitorimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare

Time Kadriaj- Tha se grupi punues ka përfunduar amendamentimin e këtij projektligji. Kryesuesi i grupit punues do të na referojë për amendamentet e propozuara të cilat do t'i votojmë.

Salihe Mustafa- Sa i përket adoptimit ndërkombëtar, deklaroi se duhet të bëjmë diçka që shtetasit e Kosovës, të cilët jetojnë jashtë shtetit, të kenë mundësi më të lehta për adoptim të këtyre fëmijëve. Përndryshe, pajtohem për adoptimin ndërkombëtar si mundësi për

fëmijët. Këta fëmijë nuk mund të adoptohen jashtë, përderisa kanë mundësi të adoptohen brenda vendit.

Gëzim Kelmendi- Deklaroi se qëndrimet e mia janë që të mos lejohet adoptimi ndërkombëtar për asnjë kategori të fëmijëve. Me Konventën Evropiane lejohet adoptimi i fëmijëve nga çiftet e martuara, të pamartuara, homoseksuale. A është më mirë që ai fëmijë të qëndrojë në vend apo të adoptohet jashtë vendit nga një çift homoseksual? Nuk ka logjikë të shëndoshë për të vepruar kështu. Nuk duhet ta lejojmë një gjë të tillë. Shteti ka obligim për t'u kujdesur për këta fëmijë. Sa i përket shtetasve të Kosovës, të cilët jetojnë jashtë shtetit dhe kanë dëshirë të adoptojnë fëmijë, atyre duhet t'u mundësohet një gjë e tillë, por kjo nuk duhet të lejohet për ata të cilët nuk janë shtetas të Kosovës. Ne duhet të gjejmë një zgjidhje për këtë çështje dhe, si Komision, ta hartojmë një amendament lidhur me këtë çështje.

Liburn Aliu- Tha se unë jam kundër që shteti të heq dorë nga qytetarët e vet, në këtë rast nga fëmijët. Shteti duhet të përkujdeset për këto kategori të fëmijëve. Ne nuk duhet të lejojmë që të kemi adoptim ndërkombëtar për fëmijët, sidomos për ata fëmijë me nevoja të veçanta. Shteti duhet të ballafaqohet me problemet, e jo t'i shmang ato. Shteti duhet ta rrisë vetëdijen e qytetarëve të vet për adoptim.

Nazane Breca- Tha se duhet të shohim realitetin. Nëse ne e ndalojmë adoptimin ndërkombëtar, atëherë ua pamundësojmë anëtarëve të familjes së fëmijës, të cilët jetojnë jashtë shtetit, që t'i adoptojnë këta fëmijë.

Time Kadriaj- Deklaroi se vetëdija te ne ka qenë e ultë për fëmijët me nevoja të veçanta, ku familja e ka fshehur fëmijën e vet me nevoja të tilla.

Flora Brovina- Tha se ne nuk kemi institucione të mirëfillta për fëmijët me nevoja të veçanta. Kemi shumë raste të fëmijëve me nevoja të veçanta, të cilët nuk kemi mundësi t'i trajtojmë ashtu se si duhet. Ne duhet që ta kontrollojmë panelin që i lejon rastet për adoptim ndërkombëtar, në mënyrë që të mos keqpërdoren këta fëmijë, përndryshe duhet t'u japim mundësi këtyre fëmijëve për adoptim.

Bahri Thaqi- Sa i përket çështjes së adoptimit ndërkombëtar, e cila ishte çështja kyçe e diskutimeve në tryezë, deklaroi se, pas informatave që i kemi marrë, i kemi hequr dilemat se si duhet të zgjidhet kjo çështje. Duhet ta pranojmë si mundësi adoptimin ndërkombëtar, si zgjidhje më e mirë për fëmijën, atëherë kur shterren të gjitha mundësitë për adoptim brenda vendit. Këtë çështje unë e kuptoj si shtrirje e dorës së ndihmës për këta fëmijë. Ne kemi punuar dhe jemi konsultuar me MPMS, me ministrin e MPMS dhe, po ashtu, kemi organizuar një tryezë për këtë projektligj, me qëllim amendamentimin sa më të mirë të këtij projektligji. Ne kemi propozuar amendamentet, si vijon:

Amendament 1

Në tërë tekstin e Projektligjit para fjalës Kosovës hyn fjala „, Republikën e“

Komisioni Funksional

Amendament 2

Në nenin 1 të Projektligjit , paragrafin 7, fshihet fjala „administrativ“ dhe të zëvendësohet me „profesional“.

Komisioni Funksional

Amendament 3

Në nenin 2 , paragrafi 1, i projektligjit, fshihet dhe riformulohet :

Në paragrafin 2.1 të nenit 2, fshihet fjala “e gjithmbarshme”. dhe në fund të paragrafit fshihet fjalia „ose sociale, pasuria, lindja ose diçka tjetër”

Komisioni Funksional

Amendament 4

Në nenin 2 , pas paragrafit 3 të projektligjit, shtohen dy paragraf të ri si vijon :

Në nenin 2, paragrafin 2.3. të ligjit, fshihet fjalia :

„ si edhe të drejtën që këto shërbime t’i ofrojë vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë nëse rrethanat e arsyetojnë këtë”.

Në nenin 2 , paragrafi 2.4 të ligjit , fshihet fjala „ ministria” dhe zëvendësohet me „Qendra për Punë Sociale “ dhe në fund të paragrafit fshihet „ në emër të Ministrisë”.

Komisioni Funksional

Amendament 5

Në nenin 5, pas paragrafit 7 të projektligjit, shtohet një paragraf i ri si vijon :

Në nenit 5 të ligjit, nënparagrafi 5.23, fshihet fjalia „ anëtarët e publikut “ dhe zëvendësohet me „ qytetarët”.

Komisioni Funksional

Amendament 6

Neni 6, i projektligjit, të ndahet në dy nene , nga paragrafi 2, të filloj neni i ri.

Komisioni Funksional

Amendament 7

Në nenin 7, paragrafin 4, i projektligjit, në fund të paragrafit pas fjalës „ komisionimit“ shtohet fjala „ dhe kontraktimit”.

Komisioni Funksional

Amendament 8

Në nenin 8, paragrafi 7 i projektligjit, pas fjalës „pa vonesë” shtohet fjala „ brenda 24 orëve”.

Komisioni Funksional

Amendament 9

Në nenin 9, paragrafi 3 i projektligjit , fshihet fjala „ mund “ dhe zëvendësohet me „ duhet”

Komisioni Funksional

Amendament 10

Në nenin 9, paragrafi 4 i projektligjit , të fshihet fjala „ e emocionale”

Komisioni Funksional

Amendament 11

Në neni 9, paragrafin 20 i projektligjit, nënparagrafi 11.21.d., fshihet fjala „, mosha 45 vjeç” dhe zëvendësohet me „, 50 vjeç “.

Komisioni Funksional

Amendament 12

Në nenin 11, nënparagrafi 12.3b i projektligjit, pas fjalës „, fëmijët” shtohet fjalia „, mbi moshën 18 vjeçare”

Komisioni Funksional

Amendament 13

Në nenin 15a, të projektligjit , paragrafët 15.3 dhe 15.7, fshihet fjala „, marrjes së “ dhe zëvendësohet me „, pranimi të”.

Komisioni Funksional

Pas diskutimeve, Komisioni me shumicë votash miratoi amendamentet e propozuara.

7. Të ndryshme

Time Kadriaj- E informoi Komisionin se kryetari i Kuvendit ka kërkuar që deri më 31 janar 2012 të hartohet plani i punës së komisioneve të Kuvendit. Propozoj që të kemi vizita në terren për çdo javë ose të paktën çdo dy javë.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka